



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 29 korrik 2015, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-II

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Ismet Beqiri, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Munguan: Teuta Rugova, Elmi Reçica, Ramush Haradinaj.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Floriana Shala- OSBE, Lumnije Murati-ZPRK; Cristopher Blair-UNDP, Lekë Batalli e Tringa Bytyqi-GLPS, Erblina Morina, praktikante –ZPRK, Mërgime Kajtazi-KDI dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 13 korrik 2015;
3. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës;
4. Formimi i grupeve të miqësisë;
5. Njoftim nga vizitat zyrtare;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më dt. 13 korrik 2015

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur, më dt. 13 korrik 2015.

3. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës;

Enver Hoxhaj lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, tha se grupi punues e ka përfunduar punën dhe i ka proceduar Komisionit, raportin për shqyrtim. Duke pasur parasysh, se në pyetësin e grupit punues, i cili u është përcjellë misioneve konsullore u janë përgjigjur vetëm pesë nga ato, kryetari, propozoi që për këtë çështje të gjendet një formë e diskutimit.

Puhie Demaku në emër të grupit punues njoftoi Komisionin lidhur me punën dhe aktivitetet e grupit punues rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Ajo tha se pas përfundimit të aktiviteteve të tij, grupi punues ka hartuar raportin me rekomandime. Njëkohësisht njoftoi se në pyetësin drejtuar misioneve konsullore, përgjigje kanë marrë vetëm nga pesë prej tyre dhe se me rastin e miratimit të raportit mbikëqyrës grupi punues ka vendosur që ta tërheq rekomandimin lidhur me ngritjen e tarifës, për heqjen e shtetësisë.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit B. Deliu Kodra, Z. Berisha, Q. Bajrami -në cilësi të anëtarëve të grupit punues lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

4. Formimi i grupeve të miqësisë;

Enver Hoxhaj njoftoi se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur, më 16 shkurt 2015, ka propozuar formimin e grupeve të miqësisë me parlamentet e shteteve të tjera dhe deklarin e deputetëve përmes formularit përkatës, se në cilin grup të miqësisë dëshirojnë të jenë anëtarë. Pas deklarin të deputetëve, listat për formimin e grupeve të miqësisë, përmes protokollit i janë përcjellë Komisionit. Ai propozoi që formimi i grupeve të miqësisë të shqyrtohet më hollësisht në njërin nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit dhe që ndërkohë grupet parlamentare të rishqyrtojnë shpërndarjen e deputetëve nëpër grupe të miqësisë.

Pas diskutimeve lidhur me formimin e grupeve të miqësisë kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Çështja e formimit të grupeve të miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deputetëve të parlamenteve të vendeve të tjera, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

5. Njoftim nga vizitat zyrtare;

Anëtarët e Komisionit u njoftuan me informatën nga vizita zyrtare e grupit punues në Zvicër dhe Gjermani dhe vendosen që e njëjta të procedohet, sipas procedurës.

6. Të ndryshme.

Bazuar në kompetencat e Komisionit, deputetët vlerësuan të nevojshme që në përbërjen e Komisionit të ketë deputetë nga të gjitha grupet parlamentare, duke theksuar se në Komision nuk ka deputetë të nga komuniteti serb, gjegjësisht nga GP-LS-i.

Anëtarët e Komisionit duke e parë të rëndësishme që në përbërjen e tij të ketë edhe përfaqësues nga grupi parlamentar LS-i, si për përfaqësim të brendshëm, po ashtu edhe për atë ndërkombëtar, vendosën që t'i drejtohen Kryesisë së Kuvendit, me kërkesë që ta shqyrtojë këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Enver Hoxhaj